

VITORE LEKA (STEFA)

BIBLIOTEKA

854-1
R 11

LA LIBERTÀ

poezi

qe

merr

fryme

pas

pushkatimitt



81H-1
211

VITORE LEKA (STEFA)

LA LIBERTA'

poezi

që

mërr

frymë

pas

pushkatimit

BIBLIOTEKA
VITORE LEKA
53 048
PCC

Shtëpia botuese «JANI VRUHO»


Berat, 1993

Redaktor: XHEVAMIR LLESHI

Kopertina: Bardhyl Buza

Poezitë u botuan nën kujdesin e
Z. ALFRED STEFA





Radiografia

Erinjët e mia
 Janë bërë shoshë
 Nga rrezet e tua
 Syri i hetuesit
 Më ndiqte pas kudo
 Si rreze rontgen.
 Në trurin tim befas zbuloi
 Virusin e trashëguar antikomunist
 Në formën e plumbit
 Në formën e thikës;
 Rrezik imperialist.

Ky sy edhe sot më është pranë
 Herë vjen si mik i zëmëruar,
 Herë vjen si shok i larguar,
 Herë vjen mbi dallgën shaluar,
 Herë vjen në rreze dielli ndriçuar;
 Gjithnjë po ai sy
 Po ei mallkim
 Po ajo emirë...
 C'ndryshoi tek ti shpirti im?!

Hetuesit e kuq

Ju këto çaste me siguri
 Flini.
 E di, juve nuk ju zë gjumi
 Jini të lodhur
 të raskapitur
 Djersa ju ka ngrirë në ballë
 Libri i Torturave hapur rri
 Gërhet bashkë me ju,
 Endrrat ju gjejnë sy hapur
 Dhe ju mezi prisni
 Të vijë mëngjesi.
 Fijet e thurura natën
 Në pranga ktheheshin ditën,
 Kurthi i zi tkurret në gji
 Dhe ngrihet përsëri.

Erdhi pranvera
 Kërmilli del
 Pi vesë;
 Endrra të bukura
 Ndoshta edhe pranga të reja.

I gëzohet diellit
Pështyn edhe rrugës.
Ja që i ka mbetur ky huq
Eshtë ngritur në këmbë
Edhe ecën
Hetuesi ynë i kuq.

Jetës

Ptu!

Je tallur liksht me mua!

Më linde mes plumbash

Më zvarrise nëpër kalldrëme

Më bëre gogol te Lëmi

Më talle në Kumsallë

Më vure te Lundra lugë hëne

Më varrose mijëra herë

Mua kufomën e gjallë...

Ligji yt!

Ferr

Dhe zemra qan.

Vdekja e fundit zvarriset

Pranë meje

Më rrethon me drithë;

Coftinë jam unë

Një hiç para Teje.

Pse qesh?

Qesh me mua vallë?

Ah, më paske harruar

Po unë jam këtu

Dhe jam gjallë.
Mos u habit
Do të jetoj përjetë
Me mall.

Më vijnë ende në vesh
Plumbat e atij pushkatimi
Valët e detit shtjenë mbi mua
E vdekur e gjallë!

La liberta'

1.

La liberta', vola piu' alta dal ciello.
 Il cielo non teme le sbarre d'una prigione.
 La prigione puo' segregare l'uomo,
 puo' uccidere l'uomo,
 ma non puo' sconfiggere la liberta'.
 La liberta' si nutre dallo spirito
 dell'uomo,
 e finche' ci sara' l'uomo,
 ci sara' liberta'

2.

C'e' nel mondo sete di liberta'.
 Liberta' e' non avere sete e fame,
 E' diritto, e' dignita'! Perche'
 Cgnuno possa essere in se stesso:
 giustizia e potere, per combattere
 Contro il terrore, la dittatura,
 l'ingiustizia: - appropriazione
 di un popolo, di una coscienza

della nostra mente,
con voi l'appoggio di chi ancora spera
per un nuovo futuro, senza
catene e senza commizzie di forza.

3.

Io sono come la musica,
una volta dolce,
una volta impetuosa,
una volta briosa,
una volta leggera,
ma triste.
Nonostante tutto, finisco con l'essere
allegra e gioiosa.

4.

Quando tu ti lasci trascinare
da questa note sublime,
anche la nota piu' stonata della vita,
sembrera' una meravigliosa sinfonia.

Vendi im

Hije e gjatë, e rëndë,
Ja ç'mora prej teje.
Një shkëmb i varur në qiel
Një gur që bie mbi det
Një hapësirë e madhe lart
Në trurin tim
Dhe një emër i bardhë
Krenari e emrit shqiptar.

Dhe unë u largova
Mora me vete
Hijen
Shkëmbin
Gurin
Dhe hapësirën.
Tani shkruaj me qerpikët larë më lotë
«Nuk të harroj kurre
Toka ime!»
Shkëmbi më bëhet dhe i butë;
Guri, anije gjigande
Hapësira nuk tretet dot në zemër.
Unë puth këtu valët e detit tim
Mbushur më pshëretima malli.

Ah...

Malli im përhapet në det si ajazëm

Dhe vjen e sjell

Puthjen e mallit tim

Në brigjet e tua,

VENDI IM

Trieste, 18 shtator 1992

I kam ikur moshës ...

Në vitin një
 Të shekullit një
 I kam ikur moshës sime
 A mosha më ka ikur mua?!
 Kam lindur me Krishtin
 Një nënë kemi të dy:
 Shën Maril
 Ai u kryqëzua
 Kurse unë mbeta gjallë
 Dhe pi gjakun e tij.
 Ah, q'them këshiu!
 Kryqëzimi; j i trupit s'është gjë
 Kryqëzimi i shpirtit po,
 Sa njerëz jetojnë vallë
 Me shpirt të kryqëzuar!
 Të kryqëzuar të përjetshëm
 Të kryqëzuar të gjallë.

Trieste, gusht 1992

Fotografitë

Larg, larg, larg,
Dhe kujtimet vijnë pranë
Në përkundjen e gjumit,
Në dritërimën e ëndrrës,
Në klithmën e mallit.
Dhe vatra rri ndezur,
Sytë gjithnjë të përlotur,
Shpirti i lodhur në ankth...

As lotët
As ankthi
As zjarri i ndezur
As shpirti në shekuj kredhur
Nuk na japin jetë.

Çdo mbrëmje
Shchim fotografitë.
Dhe heshtim
Dhe flejmë
Dhe qajmë
Dhe qeshim

Dhe hamë
Dhe... përpinqemi, jetojmë,
Kurse të gjalla përjetë mbeten
Fotografitë.

qershori 1992

Të dashurës nga ... Italia

Atë ditë u ndamë.
 Ndofta ti nuk e besoje
 Ashtu edhe unë.
 Shikoja për rrëth
 Harbonte vetmia
 që më ngjante mua,
 ndofta... edhe ty...
 Atë ditë që u ndamë
 Shikoja detin
 E në thellësinë e syve të tu
 Deti qe i thellë
 I magjepsur,
 Ashtu si sytë e tu.
 Atë ditë që u ndamë
 Nuk e di
 Ika unë
 Apo ike ti;
 Shikoja për rrëth
 Harbonte Erë e Vetmi.
 O Zot!
 Ajo më ngjante mua
 Ndofta ... edhe ty.

Ah! Ata që na ndanë!...

53048

* * *

Hej njerëz!
 Rrini një natë pa fjetur.
 Rrini dy, tre,
 Dhe lodhuni
 Të shihni sa të qetë
 Do të flini!
 Pastrohuni
 Nga poshtërsitë,
 Zoti përherë kështu
 ju ka thirrur;
 Po ju jeni mësuar
o njerëz,
 Të flini e të çoheni
 të lebetitur!

Durrës, 1990

E dashur

Nuk të harroj!

Do të dua
dhe do të vdes një ditë
me shikimin
dhe fytyrën tënde
para syve.

Mos më harro!

Kujtomë kur sheh yjet,
me shkëlqimin e tyre
shiko zjarrin
e dashurisë sime.

E pastër si ata

E bukur si ata

E pavdekshme si ata

Trieste 1992

Yjeve

A i shihni lotët e mi?
 Prekini,
 Puthini,
 Dhe lërini të rrjedhin,
 Në shtratin e mallit
 Në udhën e shpirtit
 Në trajektoren qellit
 Drejt yjeve të mi
 Atje jam edhe unë
 Atje është një copë Shqipëri.

maj 1992

Trishtimi

Ja tek më pushtove
Trishtim,
M'i ke ngulur thonjtë
Në fyt e në mendim
Dhe zgërdhihesh
I tmerruar,
I gjallë,
I hekurt,
Dhëmbështrënguar;
I squllët
I ligështuar
Qeraman i tmerruar.
Kam heshtur boll
Kam parë,
Kam vdekur mijra herë
E përsëri jam gjallë.

gusht 1990

Berat

Buzët përthyer me zemërim
 Vetullat harkuar me elegancë
 Supi i shkëmbit në trishtim
 Beli i hollë të çon ekstazë
 Syri i kaltër lotë pikon
 Qerpiku bie nën strehë, jasemin
 Flokët t'i merr era që rënkon
 Ti befas qesh me gjëzim.
 I gjatë i hollë, pendë palloi
 I lartë, i gurtë e krenar
 Diku veton burim i një përrroi
 Befas kridhesh nën diell i larë.
 Po çmendem për Ty
 po më çahet zemra për Ty
 Dhe shikoj yjet
 Njëri prej tyre po vjen ATY.

Një djaloshi shqiptar

- Genturit tim të shtrenjtë -

U vrave krejt papritur

Aksident,

Sepse aksidentalisht kemi ardhur në jetë
Nga një dëshirë e çmendur prindërore.

Tetëmbëdhjetë pranverat e tua

U tretën aq shpejt vallë?

Jo, o Zot, mos kështu,

Mos me këtë dorë kaq të gjatë.

Megjithatë Ti e di ç'bën:

E zgjodhe atë Lule për kopshtin tënd
Kopsht që ne të gjallët nuk e dimë

Në paçim fat ta shohim me mend.

U vrave krejt papritur, bir,

S'të njoha dot;

Veç zërin tënd si cicërimë

Ta kam në vesh Jetë e Mot.

Në Zërin Tënd ishte Paqja

Ishte Qeshura e Madhe aty,

Ishte Pranvera, gjithçka e jotja

Ishte Nxitimi dhe Liria për Ty.

U vrave krejt papritur
 Një lajm vrapon me nxitim
 Shokët e habitur në darkë vonë
 U rrënqethën nga tërë ky **helmim**.
 Për Ty i dashur veç për Ty
 I doja edhe duart e mijë
 E doja edhe zemrën time
 E doja edhe shpirtin tim.

Se ashtu të donte Ty Nëna
 Që po qan me ligjërim,
 Dhe tanë për Ty jeton Kënga
 Që do ta këndoymë gjer në Amëshim.

U vrave krejt pa pritur bir,
 Dhe unë s'të njoha dot.
 Oh, aksident automobilistik
 Që na mbushe jetën me lot!
 Dhe vij unë tek ti në Palmanovë
 Dhe i vë tetëmbëdhjetë trëndafila të kuq
 Dhe unë vij tek Ti në Beratin tonë
 Dhe i vë me mend tetëmbëdhjetë
 karafilë gjak
 Gjak si gjaku yt riosh...
 Kështu do të bëjnë monument në gur
 Edhe ata që do të vijnë më pas
 Ta gdhendin emrin GENTUR
 Në qiell si në një Altar.

Triste, 4 tetor 1992

Prangat

Dy unaza hekuri
Dy unaza tē mēdha bronxi
Dy unaza tē bucura argjendi
Dy unaza tē çmendura floriri;
 Kurrë jo nuk janë prej plumbi
 Kurrë jo nuk janë prej alumini
 Kurrë jo s'janë prej letre
 Kurrë jo s'janë prej zemre.
Dy unaza akull tē ftohta
Dy unaza që çajnë jetën nē mes
Dy unaza përbindështë tē ngrohta
Prej tyre mijëra herë po vdes.
 Kurrë jo!
 Dhe gjithnjë po!
E diktatura s'jeton dot.
Pa to edhe demokracia
Rri e ngrirë
I vështron me cmirë...

Zemra

Tik - Tak
 Dëgjon si troket?
 Është zemra ime,
 Që ty të thërrret.
 Tik - tak,
 Valët sjellin aty
 Thirrjen time
 Mos vallë drejt një bote

të humbur?

Zgjohu nga gjumi
 Është shpirti im
 Që ty të kërkon
 Në vetmi.
 Tik - Tak,
 Zemra ime rënkon
 Ti je larg, shumë larg,
 E di
 Sytë e bukur janë mbyllur
 Puzët lëvizin ngadalë
 Shëët! Asnjë fjalë!
 Buzëqeshja lodron
 Në buzët e tua

Vitore Leka

Apo më thërret mua vallë?!
Jam aty
Në èndrrat e tua,
të dua!

Ka dhe kështu ...

Dy gjela në luftë
Në mundje të lirë
Mbi mur kacafyten
Dhe unë
Si zonjë e mirë
Shkoj që t'i ndajë
Ndërsa ata më vërsulen
Dhe më mbysin ngadalë...

Pushkatimi

— Sipas një emisioni televiziv RTSH,
18 janar 1993 —

Tre plumba
Pa klithma
Vdekje pa sy
Dy mars ora njëzet e dy
Viti dyzetetë;
Dhe heshtja vetë.
Shpirti befas shkon në qiell
Policët ia marrin këngës shtruar
Këndojnë si në marrëzi
Pastaj hedhin krahëqafë
Automatikët e zinj
Dhe këndojnë përsëri.
Kostaq
Hamil
Tajfur
Eaba Bedri!¹⁾
Një jetë e përhershme në rini
Bri varrit pa varr

Rritet bar
Dhe vetë përroi i mbuluar
Hesht me acar.
Policët largohen ngadalë
Kënga çpon natën e ftohtë
Pas lanë Krismat pa varr.

1) Kostaq Stefa, Hamit Myftiu,
Tajfur Haznedari, Baba Bedri Carkanji
Vrarë më 2 mars 1948 në Uznovë të
Beratit.

Nënës sime

Zemër e fyter me varfërinë,
 E injerë dhe e lumtur
 E re dhe e plakur
 E bukur dhe me aq nder
 Grua dhe burrë
 Një jetë të tërë
 Zeri s'iu ndje kurrë.
 E unë
 Si të mos qaj?
 Si të mos ulërij?
 Si të mos çpoj qiejt me zëmërim?
 Si të mos ligshtohem në përgjërim?
 Pse:
 Burri - o Zot - pushkatuar!
 Qeshnin cinikët nëpër qoshe
 Tregonin me gisht:
 Ja,
 Pesë fëmijë
 Dhe varfëri.
 Sigurisht ata harronin
 Zemrën e nënës;
 Ajo buronte frymëzim
 Ajo ushqehet me krenari

Dhe priste vetëm NJË DITE.
Na rrite jetimë
gojë më gojë
Dhe ne
Sipatëm fëmijëri
Mbetëm pa rini
Kurrë s'u ngopëm me bukë
Vetëm me lot
Na dukej jeta kot.
Pranverë e mbytur në lumë
Jetë e varfër në gjumë
Dhe ti pret NËNA IME
Pret
Në pafundësi.

Buzë detit

Buzë detit luaj,
 dëgjoj pëshpërima valësh
 Dëgjoj zemërim dallgësh
 Njomen dhe unë me stërkala,
 Dhe puthja ka më kripë
 Dhe e qeshura ka më hije
 Dhe e kreħura ke më shije
 Dhe e ngrëna ka kuptim.
 Fryn erë
 Bën diell i fortë
 Deti qesh
 Deti zemërohet
 Ndërkaq mua më shkel synë
 E nis tē largohet
 Eci
 Vrapoj
 Rri
 Këndo,
 Buzë detit ndihem tjetër njeri
 Një këgë marroke me vlon në gjë.

S·dua mëshirë

S'jam lypëse jo!
 S'e duroj dot puthjen
 Dhe pastaj të më dëbosh.
 Jo!
 Dhimbjen e shpirtit

tim

ti s'e kupton dot.
 E pra, lamtumirë,
 t'i themi njëri - tjetrit,
 se,
 s'dua mëshirë.
 Mëshira lind nga goja e të gjallit,
 Mëshira endet zvarrë,
 Mëshira s'i hipën dot kalit,
 Mëshira mbetet pa bukë
 mbetet dhe pa zjarr.
 Mëshira s'qan dot
 Kurse unë qaj me lotë
 Ndonëse e vdekur - e gjallë!

Lutje zotit

O Zot!
 Bekona!
 I përjetshëm do të jesh për mot.
 Mëshirona,
 Na hidh shi në Shkretëtirat
 e Globit të Shpirtit.
 Të përunjemi,
 Mëkatet na fal,
 I plotfuqishëm dëgjoje lutjen time
 Është lutje me përgjërimë;
 Se lindëm në vendin
 ku Juda i gjallë
 Solli vdekje
 Dhe mijëra shkëttërimë.
 O zot!
 Bekona!
 Pastrona nga ligësitë
 Ty të kemi shpresë
 Ty të kemi jetë
 Në planetet e tjerë bie shi
 Kurse atje larg
 Planeti im buzëtharë
 Hesht e mediton në shkreti...
 O Zot!
 Një pikë lot!

Mosha

Iku mosha?
 Iku?
 Jo, ika unë prej saj.
 Tani e mbaj prej dore
 Si një kone.
 Unë eci përrpara me kokën lart
 Nxitoj
 Ajo vjen pas duke lehur.
 Eh,
 Ç'e do tekxa nuk i tregoj
 dot një përrallë.
 Vonë
 Kalojnë orët
 Ndër mend më vjen një kone
 E bukur, lozonjare
 Por që leh shumë.
 ^töhare pi kafe
 Një cigare ndez
 E bash këto dy vese
 Janë martuar me mua
 me shkes.
 Dhe konia leh...

Pa frikë

Kam lozur
Kam èndërruar
Kam patur ide të marra
Kam ecur përpara
Jam kthyer edhe pas
Kam patur guxim
Kam patur edhe frikë.
Një frikë e lëshuar nëpër terr
Si një qen kufiri
Turrej drejt meje.
M'u desh kohë e gjatë
T'i heq vargonjtë nga duart e këmbët
Të arratisem
Po në brigjet e tua o Det,
Dhe jetoj pa frikë.

Djemtë e mi

I ngrita në krahë atë ditë
 Mbi policë u sula si zhgabë,
 Njërin në krahë e tjetrin në gji
 Pa e kthyer më kokën pas.

Janë mbi njëzetë vjeç djemtë
 Dhe unë ashtu i lëshova lart,
 Zoti më dha fuqi të shenjtë
 T'i heq nga mënxyra e sahartë.

Askush s'më ndali dot
 Fluturonin plumbat e acartë
 Ndërkaq djemtë më shtrëngonin fort:
 O nënë, vallë do të kemi fat?

Fatin si ta kërkoni bijtë e mi
 Edhe tanj që jemi kaq larg,
 Sepse atje në tokën tonë - Shqipëri
 Do të kemi të gjithë një varr.

Oh, bij, mos më mundoni
 Jam lodhur dhe shumë për ju vuaj
 Hapni krahët, në jetë fluturoni
 Më lini ca çaste për ju të shkruaj...

Madi

Një emër
Një dritë
Një sy e një zemër
Një shpirt jemi të dy.

Mos prit prej meje qortime
Stina jote është dashuria,
Jetës mos i kërko kaq premtimë
Kaq larg, kaq larg nga Shqipëria.

Mos prit prej meje ledhatime
Jam lodhur me dorën në zemër,
Sejeta është plot me hidhërimë
Dhe kaq herë të sheh shrëmbër.

Mos prit prej meje ankime
Kurrë s'ta bëj dot fjalën dy
Se ti më erdhe me sqimë dashurie
Dhe unë t'i dhashë flatrat Ty.

Mos prit prej meje veç një puthje:
Se puthjen e narë e more nga unë,

Atëherë kur doja të ikja më tutje
Dhe fati m'u lodh: o det, o lumë!

Një emër

NJË DRITE

Një sy e një zemër

Mad, je TII!

Mangalem

Kalldräm i lëmuar
Rrugica plot hije dritë
Shtëpitë njëmbinjë ndërtuar,
E sytë vrapojnë tek TI.

Porta e zemrës - e madhe
Odat e shpirtit - gjigande
Beli i këputur - sorkadhe
Trupi laskonjë
Gjithçka e bardhë.

Dhe unë
Kaq larg
Ty të shoh çdo çast

Mirëmëngjes ti diellit i thua
I pari,
Rezet e tij krahaqafë ti i lidh
I pari,
Me sy qielilit të kaltër ti ia bën
I pari.

Dhe retë ti m'i puth gjithnjë
I pari,

Ulem të gurët e tu
I puth me radhë
Dhe qaj dhe qesh ashtu...
Si ëndërr e bardhë.

Vajza ime

Më thuaj e dashur
ç'pret ngajeta?
Ndërsa ti s'ma vë veshin
Ngre harkun e vetullës lart,
Hap paksa buzët me qortim
Dhe kthehesë habitshëm në efir.

Më thuaj e dashur
ç'pret ngajeta ti?
Ndërkaq një vrull inati
Si hije e padukshme të mbulon
Dhe e hedh çantën nga divani
E bën ecejake nëpër dhomë.

Më thuaj e dashur
ç'pret ngajeta, hë?
Ndërsa ti zë e qesh e qesh
Me vrull e si me histeri.
Ç'ke kështu, o bijë?
Ah, ke rënë në dashuri.

Buzët e tua si nga larg
Më thonë:
«Jo nënë,
Më vjen të plas
Jam krejt si ti!...»

Shikimi yt

Më trëmb ai shikim
 Më gazmon herë - herë
 Qenien time pastaj më shkrif
 Dhe dridhem si gjethe në erë.
 Më tmerron ai shikim
 Sytë e ngulur turrjelë tek unë
 Zemra më mbushet me trishtim
 Ndërsa të kam pritur aq shumë.

Po më çmend ai shikim
 Herë sy i ftohtë akull i ngrirë
 Herë shpuzë që digjet me përgjërim,
 Herë pasqyrë e zemrës sime të shkrirë.

Më trimëron ai shikim,
 Më jep ti puthjen tënde me sy
 Dhe buzët i lëviz me aq nxitim
 Kështu e gllabërojmë planetin të dy.

Telefonata

Ka kaluar me kohë mesnata
 Dhe ti më vjen papritur:
 Një zile e fortë nga telefofnata;
 Zëri i shenjtë ai më ka thirrur.

Dhe unë hova menjëherë
 Braktisa gjumë e shtëpi
 U nisa fluturim nëpër re
 Për të ardhur mu tek ti.

Eca, eca ndër mendime
 Malli m'i hapi krahët fort
 Malli më mbyti me përqafime
 Malli më shtyn të derdh lotë.

Pastaj një kthim i merakosur
 Zëri yt. Mos, një minutë
 eshtë e shtrenjtë!
 Na mbyti mallin para e flamosur
 Saqë nxitojmë të ikim sa më shpejtë.

Per jo, unë dua të rri me ty
Le të paguajmë lekë e flori
Se s'kam ku t'i gjej një minutë e dy
Kur jeta më ikën larg teje tanë.

Oh, një telefonatë,
Një zë zileje i shenjtë,
Le të kesh kaluar ti mesnatë
Dua të flas me ty o i shtrenjtë.

*Mikeshës sime
Xhokonda Amadei*

Duart e tua
 Gjymtyrë të tronditür
 Akullimë e thatë
 Vdekje e shkretë syndritür
 Dhe lutja jote e gjatë.
 Vajzë e menduar
 Grua që me fatin luan
 Burim ngrohtësie
 Një premtim i rrallë,
 Droga e frikësuar prej teje
 Dhe shpirti yt
 Si mullinjtë e vjetër bluan.
 Venat e tua të brishta
 Mbrojtëse e pambrojtur
 Vdekja tërhiqet zvarrë
 Kërkon lulen tënde të rrrolur.
 Pusia është aty
 Një kurth i fshehur
 Botën e ka pushtuar një sy
 Qiklop i dashuruar me Ty.

Poezinë që i mora bijës sime

Mos më vështro ashtu
 Poezinë ta dhashë unë ty
 Apo ti ma prure këtu?
 Ndërkaq të shoh ndër sy.
 Të kam dashur ti s'e di
 Dhe nuk ke si ta dish
 Ka qënë një moshë që unë e ti
 U bëmë anonimë të dashurisë.
 Ka qënë një moshë e di
 Kur ne pér herë të parë
 U pamë në pasqyrë
 Pér kë, pér cilin vallë?
 Kemi shkruar letrat radhë
 Çdo ditë çdo çast ngujuar
 Anonimi kurrë s'u bë i gjallë
 Ti binte ajo letër në duar.
 Ka qënë një moshë si Ti
 Fytyrqeshur, e bardhë si Ti
 Zemërbukur, e trishtuar si Ti
 Kaq. Ta mora unë këtë Poezi
 Dhe Ti do të më falësh
 Bijë.

Novela

Një telefonatë.
 Novela?
 S'e di.
 E qeshura ngrihet si dallgë
 Fjalët më vijnë pranë.
 A e di Novela
 Se shtëpia ime ka si komshi të përhershëm
 Detin?
 E di Novela
 Se Durrësi im vjen tek unë
 Puth Triesten
 Me valët e tij?
 A e di Novela
 Se dallga e detit
 Mban gjallë kujtesën time
 Trokitje shpirtmirë
 Si Ti.
 A e di Novela
 Se unë thur vjersha për detin
 Po një varg vallë
 Nuk e shkrojta dot për ty?
 Ja, mësoje tanë.

Mamurras

Një lule përpara dërës
Komshitë te pragu i zemrës
Oborri i heshtur armiqësor
Shtëpia me shpirt gruaje këndon
Farërat hedhin shtat vjeshtës
Symbyllur përballë vdekjes.

Derën përballë rrugës së madhe
E kam lënë gjithnjë hapur
Lutja e klasës tani është formale
E zinxhirët gjallë janë mbajtur.

Të gjithë i kam njohur
Pleq e fëmijë të rritur
Rrugës dhe tani kalojnë
Njerëz, vetura, kamionë.
I njoh dhe tani nga hapat
E kjo nuk është pak.

Nën dritare gjer vonë
Përgjonte gjithnjë një i gjorë.

Ndoshta dhe tani rri atje
Me veprën e Vampirit Enver.

Nuk ka asnjë deklaratë
Dhe ka mbetur krejt pa tituj
Mamurras i emër i gjatë
Borxhet e shpirtit si fishkuj.

Emigrant

(Ia kushtoj djalit të mikut tim Abdulla Berberi, vrarë aksidentalisht.)

Nata kullon ngricë e terr
Veshët më dëgjuan pika shiu
Larg në vendin tim fryn erë
Ajo vjen tek unë me frysë njeriu.

Nata zbardhet krejt me ëndrra
Dita është ngarkuar krejt me punë
Gjithçka gryhet tek unë brenda
Këngët më kthehen të gjitha në zhurmë.

Ai, unë, një nga ata
Heshtin përballë mrekullisë
Emigrant një emër, refugjat,
Botës së qytetëruar i pi sisë.

Dhe nxin toka dhe nxin qielli
Era fryn gjithnjë si e marrë
Njeri-tjetrin gjejmë me fytyrë nga dielli
Vetëm shpirtin kemi pishtar.

Aventura

Deti i rrafshët, deti i qetë.
 Aventura më përfshin dhe mua
 Lë pas nëpër natë heshtjen.
 Dhe ja drejt botës që m'u mohua.
 E di,
 Më shohin shumica me cmirë
 Azil Politik
 Dhe mjerimi i thellë mu në shpirt
 Rikrijohet njëriu
 Pajtim klasik!...
 Kush na çoi drejt Aventurës?
 Vetëm një Hajdut
 Vetëm një Fashist
 Vetëm një Gjakpirës:
 Partia e punës...

*Mikut tim
Masrur Imani*

Mbi buzën e qielilit
Rri vetë Kryelartësia
Boshësia e marrësisë fle
Gozhdë e lysosur me gjak si ftohtësia
Diku Liria vdes
Dhe vdekja lind
Ti pers i vjetër je aty
Botën me sy e përpin.
Tej perëndimi si grackë
Ulet ngadalë
Nesër ëgimi i zjarrtë
Të dhuron Ty një penelatë.
Fugja gjakoset me botën
Dhe zemra e saj rreh me vrull
Ti pers i ri puthur me tokën
Talentin e ke veshur si zhgun.

Vala e syrit

Syri është si deti
 Ka dallgë e stuhi,
 Është i qetë e pa valë
 Është edhe i sertë ai.

Syri është si deti
 Dallga ngrihet lart
 Mbush edhe globin ujë
 Kur loti i hedh shtat.

Syri është si deti
 Vala rreh mbi shkëmbinj
 Dhe pyllin me qerpikë,
 Më pas platitet në qetësi.

Syri është si deti
 S'ka më të bukur në botë
 Se e qeshura e tij,
 Dhe unë hesht
 e kredhur në letë.

Kukullat

Shihen në pasqyrë ato
Krihen me të tjera duar
Qeshin të kurdisura
Dhe heshtin e nuk u vjen zor.
Zgërdhihen me dhëmbët jashtë
Qajnë me ngashërim
Ecin dhe shpejtë dhe ngadalë
Përqeshin me ngashërim.
Flasin e flasin në mbledhje
E s'mbarojnë kurrë
Më pas një gotë e kthejnë
Si burri me burrë...
Dhe dridhen së ftohti ato
Dhe mbyten me djersë
I lajnë fytyrë e duar
Dhe bien në mendim «të thellë».
Kohë kukilash
Trazira të zbehta
Vdekje të thjeshta,
Dhe thonë: jemi në demokraci!...

Të jesh njert

Të jesh njeri
 O Zot,
 Nuk është meritë.
 Thonjtë e varfërisë
 Ngulen më tyt
 Dhe njeriu
 bukën përtyp.
 Anbthi i pasturisë
 Si thikë në zemër,
 Njeriu s'di ku të ulet
 u shtyp.

Të jesh Njeri
 O Zot,
Vetëm është **meritë**.
 Vetëm një shpirt
 E di
 Si ngriheash lart
 Ti Njeri!

Përqeshja

Gjuha nganjëherë jashtë
E përqeshura.
Syri që lëviz ngadalë,
Balli i rrudhur lehtë
Faqja një muskul i hollë
Qafa përdridhet - ngjalë.

Flokët e hedhur mënjanë
E përqeshura.
Fjalë të hidhura
Herë të thëna me zjarr
Shpesh buza e ngritur lart,
Herë të tjera heshtje e gjallë.
Ti je aty
I përqeshur.
Shteti që përqeshjen s'e lë
As vetë s'duhet tă qeshë më.

Hëna e ngrënë

Vetull e harkuar vajze
 Lart në qiel,
 Ta shkoj dorën me ngadalë
 Dhe të puth njëherë?

Endacake,
 Kush ta preu harkun ashtu,
 Kush ta theu qelqin në sy,
 Mos vallë nata e zezë pis,
 Mos vallë dielli i fshehur diku,
 Mos vallë shpirti i agonisë?

Jo,
 E ngrënë moj Hënë
 Ty puthja e parë të bëri ashtu.

PASQYRA E LËNDËS

| | | |
|-----|------------------------------|----|
| 1. | Rodiografia | 5 |
| 2. | Hetuesit e kuq | 6 |
| 3. | Jetës | 8 |
| 4. | La liberta' | 10 |
| 5. | Vendi jm | 12 |
| 6. | I kam ikur moshës | 14 |
| 7. | Fotografitë | 15 |
| 8. | Të dashurës nga Italia | 17 |
| 9. | x x x | 18 |
| 10. | E dashur | 19 |
| 11. | Yjeve | 20 |
| 12. | Trishtimi | 21 |
| 13. | Berat | 22 |
| 14. | Një djaloshi shqiptar | 23 |
| 15. | Prangat | 25 |
| 16. | Zemra | 26 |
| 17. | Ka dhe kështu | 28 |
| 18. | Pushkatimi | 29 |
| 19. | Nënës sime | 31 |
| 20. | Buzë detit | 33 |
| 21. | S'dua mëshirë | 34 |
| 22. | Lutje Zotit | 35 |

| | |
|-----------------------------------|-----------|
| 23. Mosha | 36 |
| 24. Pa frikë | 37 |
| 25. Djemtë e mi | 38 |
| 26. Madi | 39 |
| 27. Mangalem | 41 |
| 28. Vajza ime | 43 |
| 29. Shikimi; yt | 45 |
| 30. Telefonata | 46 |
| 31. Mikeshës sime Xhokonda Amadei | 48 |
| 32. Poezinë që i mora bijës sime | 49 |
| 33. Novela | 50 |
| 34. Mamurras | 51 |
| 35. Emigrant | 53 |
| 36. Aventura | 54 |
| 37. Mikut tim Masrur Imani | 55 |
| 38. Vala e syrit | 56 |
| 39. Kukullat | 57 |
| 40. Të jesh njeri | 58 |
| 41. Përqeshja | 59 |
| 42. Hëna e ngrënë | 60 |

Tirazhi 2000 kopje

Shtypur në shtypshkronjën e Beratit

Kopertina - shtypshkronja «11 shkurti» Tiranë

Botues: Arian Lleshi, Rruga «Hamdi Vrioni» 22,
tel. 2486 Berat.



VITORE LEKA (STEFA)

Lindi në Berat më 5 shkurt 1941. I ati,
Kostaq Stefa, – pushkatuar
nga diktatura enveriste më 1948.
E ëma, Eleni, i rriti të pesë fëmijët
në varfëri të plotë.
Vitorja është një nga ata që shqyen dyertë
e iktaturës më 2 korrik 1990.
Jeton familjarisht
në Trieste (Itali).
Ky është libri i saj i parë.